



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА  
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 3 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i njohur KSHPK (në tekstin e mëtejshëm) në seancën e 77-të, të mbajtur më 14.11.2022, morri vendimin vijues:

#### VENDIM

Veprimi ndaj lëndës me numër 12-3652/1 datë 01.10.2021, NDËRPRITET  
KSHPK-ja konstatoi se nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm ndaj lëndës.  
Lënda me numër 12-3652 të vitit 2021 të mbyllet dhe të arkivohet .

Vendimi i KSHPK-së, në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

#### Arsyetim

Lënda me numër 12-3434/1 të datës 01.10.2020 është formuar në bazë të denoncimit të marrë nga ///. Sipas pretendimeve në denoncim, në orët e mëngjesit të datës /// punonjësit e /// kanë marrë donacion – dhuratë rroba/uniformë zjarrfikëse nga kandidati për kryetar komune ///, i propozuar nga ///. Nga KSHPK-ja kërkohet ta rishqyrtojë këtë rast në përputhje me kompetencat e saj ligjore. Në shtojcë të denoncimit është dërguar regjistrim i ekranit nga faqja e internetit e Facebook si mbështetje për akuzat.

Pas këqyrjes së përmbajtjes së denoncimit dhe provave të paraqitura, KSHPK-ja kërkoi veprime kompetente nga /// dhe nga këqyrja e provave të paraqitura rezultoi se në ditën dhe datën e shënuar në denoncim, në ///, nuk është mar asnjë donacion. Gjegjesisht, me këqyrjen e librit të detyrës, dhe pas bisedës me punonjësit, /// raportoi se nuk kishte indikacione për marrjen e ndonjë donacioni nga ///. Prej aty, KSHPK-ja i vlerësoi pretendimet në denoncim si të pabazuara në tërësinë e tyre.

Sipas sa më sipër, KSHPK-ja vendosi si në dispozitë të këtij vendimi.

Dorëzuar deri te:  
Parashtruesi

Përgaditi: Mr D. D.  
Miratoi: Mr.Sh. S.

КОМИСИОНИ СХТЕТЁРОРЁ  
ПЁР ПАРАНДАЛИМИН Е КОРРУПСИОНИТ  
КРЈЕТАРЕ,  
Biljana Ivanovska

